



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE  
SANKSIONEVE

Data: 20 Janar 2021

Nr: 03

VENDIM I NDËRMJETËM  
PËR SHQYRTIMIN BASHKËRISHT TË KËRKESAVE ANKIMORE NR.01 DHE NR.02  
TË PARAQITURA NË KQZ NË DATËN 18.01.2021

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 20.01.2021, me pjesëmarrjen e:

Elvin LAKO	-	Anëtar
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore nr. 1 dhe nr. 2, të paraqitura në KQZ në datën 18.01.2021.

**BAZË LIGJORE:** Nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 132 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenin 19 të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,



## V Ë R E N:

Z. Arben Qalliu, ka paraqitur pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 1 regj, datë 18.01.2021 dhe plotësimin e kërkesës ankimore nr. 1/1 datë 20.01.2021.

Subjekti politik Lëvizja Socialiste për Integrim, ka paraqitur pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 2 regj, datë 18.01.2021.

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, në datën 20.01.2021, me vendimet nr. 1 dhe nr. 2, vendosën të kalonin për shqyrtim dy kërkesat ankimore të paraqitura në KQZ në datën 18.01.2021. Relatorët e kërkesave ankimore përkatësisht z. Ilirjan Rusmali dhe z. Elvis Çefa kakonstatuan se, të dy kërkesat ankimore kishin të njëjtin objekt ankimi: Ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.7, datë 14.01.2021 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuara në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionerit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj z, Arben Qalliu.

Në zbatim të nenit 19 pika 1 të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, përcaktohet se, *KAS përpara ose gjatë shqyrtimit të një ankimi administrativ, vendos shqyrtimin bashkërisht të tij me një ose më shumë ankime të tjera, të paraqitura nga subjekte të ndryshme kundër të njëjtit vendim.....*

Përsa më sipër, KAS-i vendos bashkimin e kërkesave ankimore nr. 1 dhe nr.2 të paraqitura në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve datë 18.01.202 dhe të shqyrtohen në një seancë. Duke qenë se kërkesa ankimore nr. 1, datë 18.01.2021 është regjistruar më parë në regjistrin e ankimeve se kërkesa ankimore nr. 2, datë 18.01.2021, atëherë të dy kërkesat ankimore do të relatohen nga z. Ilirjan Rusmali.

## PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b” dhe 132 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 19 pika 1, të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”,



## VENDOSI:

1. Shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore nr. 1, datë 18.01.2021 të paraqitur nga z. Arben Qalliu dhe kërkesën ankimore nr. 2, datë 18.01.2021 të paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Socialiste për integrim.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 22.01.2021, ora 10:30, nga relatori z. Ilirjan Rusmali.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
3. Vendimi është i formës së prerë dhe nuk mund të bëhet ankim.

**Elvin LAKO** - **Anëtar**

**Elvis ÇEFA** - **Anëtar**

**Ilirjan RUSMALI** - **Anëtar**

**Koli BELE** - **Anëtar**

**Ledio BRAHO** - **Anëtar**

